

PERMBLEDHJE JO-TEKNIKE

NDRYSHIMI I KUSHTEVE TE LEJES SE MJEDISIT TE TIPIT B PN-2101-05-2024

Zhvillues Shoqëria: “VANI COPMPANY” Sh.p.k

Vendndodhja: Zona minerare Nr.1185/1, Objekti “Qafe Ujku”, Njësia Administrative Suc,
Bashkinë Klos, Qarku Dibër.

Fusha e Veprimtarise:

ID Aktuale: ID 3.7 Nxjerrja e mineraleve, reres dhe argjiles nga minierat me shfrytezim ne qiell te hapur dhe nga guroret (mineral Kromi).

ID e Shtuar: ID 3.6 Minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to dhe ID 3.12 Impiantet e pasurimit të mineraleve.

Hartoi Raportin

Eksperte Mjedisi

Znj. Elidiana Shehu

Dhjetor , 2024

Përmbajtja

Përmbajtja.....	1
HYRJE.....	2
1. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	2
1.1 Qëllimi i projektit të propozuar	2
1.2 Planimetria e vendodhjes.....	3
1.1 Informacion për qendrat e banuara në zonën ku do të zhvillohet projekti	7
1.2 Përshkrimi i projektit të propozuar	7
1.2.1 Punimet e hapjes dhe shfrytëzimit të minierës nëntokësore	7
1.2.2 Pasaportat e punimeve të çpim plasjes për frontet e prodhimit, llogaritja e punimeve të shpim plasjes.....	8
1.2.3 Percaktimi i vendit për depozitimin e sterileve, llogaritja e kapacitetit depozitues.....	9
1.2.4 Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë.....	9
1.3 Instalimi i impiantit të pasurimit të mineralit të kromit.....	10
1.3.1 Përdorimi i ujit në proces	18
1.4 Infrastruktura ndihmëse e nevojshme (rruge aksesit, furnizim me ujë, energji, infrastruktura për mbetjet – si do të menaxhohen mbetjet e shpimit).....	20
1.5 Programi për ndertimin, kohezgjatjen e ndertimit	21
1.6 Lendet e para që do të përdoren për ndertimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndertimi, ujë dhe energji);	21
1.7 Informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;.....	22
1.8 Informacion për alternativat e marra në konsideratë.....	23
1.9 Të dhëna për përdorimin e lendeve të para gjatë funksionimit	24
1.10 Aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit	24
1.11	Error! Bookmark not defined.
1.12 Identifikimi dhe masat zbutëse	25

HYRJE

Propozuesi i projektit, shoqëria “VANI COMPANY ” sh.p. k është një kompani me eksperiencë shumëvjeçare në fushën e shfrytëzimit dhe pasurimit të kromit në vendin tonë, specifikisht në Njësia Administrative Suc, Bashkinë Klos, Qarku Dibër.

Aktualisht subjekti është në kushtet e shfrytëzimit sipërfaqësore të objektit mineralar “Qafë Ujku” me një karrierë në qiell të hapur që prej vitit 2012, zonë minerare kjo ekzistuese e pajisur me Leje Minerare Nr. 1185/1, datë 06.01.2012 në emër të sunjektit “Verina” Sh.p.k, ku ky i fundit ka transferuar lejen minerare dhe gjithë dokumentacionin përkatës tek shoqëria “Vani Company” Sh.p.k.

Shoqëria “Vani Company” Sh.p.k. është pajisur me Leje Mjedisore të tipit B me PN-2101-05-2024, Akt-Miratim Nr. 2992 Prot, datë 02.05.2024, Nr. i identifikimit te lejes 4684, K.Nr. 33.

Aktualishtë sic edhe e cituam shoqëria është në kushtet e shfrytëzimit sipërfaqësorë të objektit mineralar “Qafë Ujku”. Mirëpo në bazë të projekteve dhe nevojave të tregut blerës ka bërë shoqërinë të rishikoj edhe njëherë kushtet e Lejes Mjedisore të tipit B me PN-2101-05-2024, ku ndryshimet e propozuara do të konsistojnë në shfrytëzimin e galerisë ekzistuese nëntokësore dhe instalimin e impiantit të pasurimit të mineralit të kromit.

Për ndryshimet e propozuara shoqëria ka njoftuar Agjencinë Kombëtare të Mjedisit nëpërmjet Shkresës Nr. 9119., datë 30.08.2024 me lëndë “Kërkesë për ndryshim të kushteve të lejes mjedisore të tipit B me PN-2101-05-2024”. Ku pas shqyrtimit të kërkesës, nëpërmjetë shkresës me lëndë kthim përgjigje, Agjencia Kombëtare e Mjedisit njofton se ndryshimet e propozuara Në bazë të Shtojcave I dhe II, të Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vleresimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar, duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM-ës. (Bashkangjitur në Shtojcën Nr.1 gjeni shkresën kthim përgjigje).

1. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1.1 Qëllimi i projektit të propozuar

Projekti që kërkohet të zbatohet nga shoqëria "Vani Company" Sh.p.k, ka për qëllim shfrytëzimin e rezervave minerare në zonën minerare 1185/1, objekti “Qafë Ujku”, (galeri ekzistuese) për të realizuar nxjerrjen më tej të mineralit të kromit nga rezervat e vendburimit. I gjithë minerali i përfutur nga rezervat e vendburimit do të nënshtrohet më pas impiantit të pasurimit duke prodhuar kështu koncentrat kromi me përmbajtje 49% Cr₂O₃, i rikuperuar në masën 66%.

Aktualishtë sic edhe e kemi cituar në hyrje të këtij raport vlerësimi, shoqëria “Vani Company” Sh.p.k është në kushtet e shfrytëzimit sipërfaqësor të objektit mineralar “Qafë Ujku”, ku për zhvillimin e këtij aktiviteti ajo është pajisur me Leje Mjedisore të tipit B me PN-2101-05-2024, Akt-Miratim Nr. 2992 Prot, datë 02.05.2024, Nr. i identifikimit të lejes 4684, K.Nr. 33.

Mirëpo në bazë të projekteve dhe nevojave të tregut blerës ka bërë shoqërinë të rishikoj edhe njëherë kushtet e Lejes Mjedisore të tipit B me PN-2101-05-2024, ku ndryshimet e propozuara do të konsistojnë në shfrytëzimin e galerisë ekzistuese nëntokësore dhe instalimin e impiantit të pasurimit të mineralit të kromit. Për këtë qëllim shoqëria po i nënshtrohet procedurës së vlerësimit të ndikimit në

mjedis për projektin “Shfrytëzimi me galeri nëntokësore e mineralit të kromit dhe instalimi i impiantit të pasurimit”, vendburimi “Qafë Ujku”, zona minerare Nr.1185/1.

Projekti i propozuar nga ana e shoqërisë do të konsiderohen si investime parësore të cilat lidhen ngushtësisht me njëra-tjetrën dhe ndihmojnë në menyrë të drejtpërdrejtë shoqërore, duke përbushur kështu pikë së pari nevojat për sigurimin e lëndës së parë të mineralit të kromit. Gjithashtu instalimi i impiantit të pasurimit të mineralit të kromit do të jetë në funksion të aktivitetit kryesor sic është shfrytëzimi i mineralit në vendburimin “Qafë Ujku”, ku e gjithë sasia e mineralit të kromit e cila do të nxirret nga aktivitetet e shfrytëzimit nëntokësore dhe sipërfaqësorë në zonen minerare do të nënshtrohet procesit të pasurimit duke prodhuar kështu koncentrat kromi me përmbajtje 49% Cr₂O₃, i rikuperuar në masën 66%.

Projekti është në sinkron të plotë edhe me strategjinë kombëtare të zhvillimit të industrisë nxjerrëse e përpunuese në të cilën bën pjesë e ze një peshë të madhe edhe industria e kromit ndër më të vjetrat e me traditë në vendin tonë.

Elementet e zgjedhur për shfrytëzimin dhe pasurimin e tij, janë bashkëkohore, duke përmirësuar menyrën e pasurimit duke instaluar një fabrikë bashkohore, përmirësuar treguesit e nxjerrjes nga nëntoka etj.

Zhvillimi i një aktiviteti ekzistues, i cili operon në zonë prej vitesh, dhe aq më tepër zgjerimi i komponentëve të tij do të ndikojë pozitivisht edhe në zbutjen e problemeve të prehta sociale në këtë zonë.

1.2 Planimetria e vendodhjes

Vendburimi ndodhet në Zonën Minerare Nr. 1185/1, Objekti “Qafë Ujku”, Njësia Administrative Suc, Bashkia Klos, Qarku Dibër. Vendburimi “Qafë Ujku” ndodhet në veri të objektit Qafa e Burrelit dhe në veri-lindje të objektit të Qafë Dardhës. Qendrat e banuara më të afërta të identifikuar me objektin minerarë janë fshati Patin, i cili gjendet i pozicionuar rreth 4 km në jug-perëndim të zonës minerare, rreth 4.5 km në vija ajrore nga objekti gjendet fshatit Kudari, ku më pas një distancë më të konsiderueshme gjendet fshatrat si Ceruje, dhe Qyteti i Klosit.


Zona minerare është e vendosur në një zonë malore, ku mungojnë qendrat e banuara apo objektet e banimit përreth tij. Zona ka formë shpatore me një luginë të butë malore, e vendosur rreth +1350 deri +1800 m mbi nivelin e detit. Relievi në zonën e aktivitetit shtese të kërkuar bie gati në menyre të njetrajtshme në drejtim të perëndimit. Ky vendburim ka të njëjtën vazhdimësi të situatës gjeologjike me atë të v-b të Qafës së Burrelit. Shtrirja e vendburimit është meridionale dhe rena e tij është lindore me kënd 35-45° e me rralle deri 65°.

Në veri të zonës kalon zgjatimi fundore i perroit të Mxhenit të Madh që më poshtë bashkohet me perrenj të tjerë, dege të lumit të Matit.

Sipërfaqja e përgjithshme e zonës së liçencuar për shfrytëzim është 0.782 km² ose 78.2 ha, ndërkohë që sipërfaqja e karrierës sipërfaqësore që ka nisur shfrytëzimin do të shfrytëzojë në total një sipërfaqe prej 0,01 km² ose 10ha, ku kapaciteti i projektuar për shfrytëzimin sipërfaqësorë është rreth 500 ton/vit.

Kurse përsa i përketë nëntokës ajo do të shfrytëzohet nëpërmjet galerisë nëntokësore ekzistuese, ku hyrja e saj përcaktohet nëpërmjet koordinatave të mëposhtme. Duke qenë se galeria nëntokësore është ekzistuese ajo përgjatë shfrytëzimit të saj do të përfshijë në shumicën e rasteve punime ekzistuese për nxjerrjen e mineralit dhe punime të reja të cilat do të kryejnë zbulimin e ri të trupit të rezervave të mineralit të kromit në objektin “Qafë Ujku”. Sasia e parashikuar e cila përlllogaritet të nxirret nga punimet nëntokësore pritet të jetë rreth 4000 ton/vit. Sasi kjo e përlllogaritur nga ana e inxhinierëve të kompanisë duke u bazuar në rezervat e vendburimit.

Për shfrytëzimin e vendburimit “Qafë Ujku”, zona minerare Nr. 1185/1, shoqëria “Vani Company” Sh.p.k do të shfrytëzojë trupat e xeherorëve të kromit nëpërmjet shfrytëzimit në sipërfaqe (ku aktualisht ajo po vazhdon shfrytëzimin e saj në kushte dhe regjim normal pune), dhe shfrytëzimin nëpërmjet galerisë nëntokësore, duke aktivizuar dhe vendosur në funksion galerinë ekzistuese.



Pozicioni i zones minerare ne lidhje hartën topografike

Tabela 1: Koordinatat e Zonës Minerare Nr.1185/1, Objekti “Qafë Ujku”.

Kordinatat e zonës së lejes Minerare Nr. 1185/1				
Sistemin Gauss-Kruger			KRGJSH	
Nr	X	Y	X	Y
1	4430700	4604580	513972	4604127
2	4430700	4605000	513967	4604547
3	4432250	4605000	515517	4604565
4	4432250	4604380	515524	4603945
5	4432072	4604382	515346	4603945
6	4431994	4604423	515268	4603985
7	4431995	4604385	515269	4603947
8	4431630	4604395	514904	4603953
9	4431490	4604580	514762	4604136
10	4430700	4604580	513972	4604127

Tabela 2: Koordinatat e Galerisë Nëntokësore

Kordinatat e hyrjes së galerisë dhe niveli deri ku do të shkojë shfrytëzimi				
Sistemin Gauss-Kruger			Krgjsh	
Nr	X	Y	X	Y
1	4431636	4604729	514906	4604287

Tabela 3: Koordinatat e Vendepozitimit të sterileve të gjeneruara nga punimet e galerisë nëntokësore

Vendepozitimi i sterileve të gjeneruara nga punimet e galerisë nëntokësore				
Sistemin Gauss-Kruger			Krgjsh	
Nr	X	Y	X	Y
1	4431763	4604663	515034	4604222
2	4431763	4604814	515032	4604373
3	4431650	4604814	514919	4604372

4	4431650	4604663	514921	4604221
---	---------	---------	--------	---------



Planvendosja e projektit te propozuar

1.3 Informacion për qendrat e banuara në zonën ku do të zhvillohet projekti

Administrativisht zona ku do të zhvillohet projekti gjendet në bashkinë Klos, e cila kufizohet në lindje me bashkitë Bulqizë dhe Dibër, në veri me bashkinë Mat, në jug me bashkinë Tiranë, në perëndim me bashkitë Mat, Krujë dhe Tiranë.

Qendrat e banuara më të afërta të identifikuara me objektin minerarë janë fshati Patin, i cili gjendet i pozicionuar rreth 4 km në jug-perëndim të zonës minerare, rreth 4.5 km në vija ajrore nga objekti gjendet fshatit Kudari, ku më pas një një distancë më të konsiderueshme gjendet fshatrat si Ceruje, dhe Qyteti i Klosit.

Zona minerare është e vendosur në një zonë malore, ku mungojnë qendrat e banuara apo objektet e banimit përreth tij.

1.4 Përshkrimi i projektit të propozuar

Sic edhe e kemi cituar më sipër, shfrytëzimi në vendburimin “Qafë Ujku”, do të realizohet nëpërmjet shfrytëzimit të kombinuar me galeri nëntokësore dhe më karrierë sipërfaqësore, një shfrytëzim i tillë do të bëjë të mundur nxjerrjen e rezervave të nevojshme të mineralit të kromit.

1.4.1 Punimet e hapjes dhe shfrytëzimit të minierës nëntokësore

Hyrja e galerisë është sipas kordinatave të specifikuara në tabelën e mësipërme. Punimet në galerinë nëntokësore do të fillojnë:

- Galeria rruga kryesore janë rreth 250 ml punime ekzistuese në kuotën 1587 planifikohen edhe rreth 25 m punim horizontal dhe 16 m furnel punim vertikal.
- Nënkatë 1 kuota + 1602 ka rreth 220 ml punime ekzistuesu planifikohen dhe rreth 90 ml punime horizontale e vertikale të paraqitura në planimetri.
- Nënkatë 2 kuota +1610 ka rreth 30 ml punime ekzistuese planifikohen edhe 20 te tjera.
- Nënkatë 3 nuk ka punime ekzistuese për shkak të punimeve të mëparshme por planifikohen të behen rreth 60ml punime në kuotën +1620.

Niveli (Horizonti deri ku do të shkojë shfrytëzimi)	X	Y	Z
	4604500.000	4431680.511	1560

Hapja dhe shfrytëzimi i rezervave të specifikuara, projektuara do të përdoren duke përdorur si fillim punimet ekzistuese të vjetra dhe gjithashtu do të hapen edhe punime të reja kërkimi, furnele dhe punime prerëse. Lartësia e punimeve do të jetë 2m në hapje dhe 1.8 m në dritë ku gjërsia do të jetë 1.6 m në dritë.

Shkëmbinjte rrethues të trupit janë të njejtë si në pjeset e tjera të vendburimit. Sistemi i shfrytëzimit i propozuar do të jetë me shembje nënkati.

Drejtimi i terheqjes do të jetë nga kufiri për në qendër. Ku lartësia e nënkatit do të jetë 8 metra. Transporti në nënkat do të bëhet me vagona shkarkues 0.86 m³. Prej ketej minerali shkarkohet ne furnelin vertikal të katit i cili është projektuar me dy ndarje. Treguesit tekniko-ekonomik të sistemit parashikohen:

- Lartësia e katit: 2 m
- Lartësia e nënkatit: 8 m
- Gjatesia e bllokut: 40 m
- Trashësia mes. e trupit: 1.5 m
- Koeficienti varferimit: 10%
- Koeficienti humbjes: 20%
- Sasia e ujrave nentokesore: 0
- Kendi i renies: 35 °
- Zhytja e minieres(niveli maksimal) do të ngihet me nenkate deri kuoten +1620

Kapaciteti nxjerrjes mesatar parashikohet rreth 4000 ton krom/vit nga nentoka.

Gjendja e rezervave ne total sipas vlerësime është 15000 ton me cilesi te mesatarizuar 24,40% Cr2O3 per shfrytëzim në nëntokë. Sipas shpimeve të realizuara në vitin 2023 në dy prerje në prerjen I-I dhe në prerjen II-II me azimut 350 grad, në profilin I-I janë kryer shpimet 47,48,49 dhe në profilin II-II janë kryer shpimet nr 50,50/1,50/2 dhe shpimi nr 51. Në bazë të shpimeve janë zbuluar në prerjen -2 rrezerva C1, 500 ton.për arsye se kemi bere ne vitin 2017 disa shpime të cekta për të konturuar vazhdimsinë e trupit në rënie, të shfritëzuar me karrierë në vitin 2023 dhe e lënë në tektonikë, sepse ne ate vit u paisem me një sondë shpimi. Projektua dhe hapëm Shpimet nr 1,2, dhe 3 me azimut 1530 dhe me kend 00,-320dhe -66 0 e takoj trupin e mineralit ,po ashtu per ta takuar në shtrirje projektua edhe shpimit nr 4,5,6 me azimut 1150 dhe me kend +100,-150 dhe ,500 ku edhe ne shtrirje u takua trupi i mineralizuar, kjo bëri që të shtohet në fondin e rezervave edhe me 800 ton krom në këtë objekt.

Gjendja e rezervave është si më poshtë:

Nr	Trupi	Horizonti	Zona e Prof.	Kat.	Sasi Ton	%Cr2O3	Kofic. H	Kof. V
1	Nr.1	1590 – sip.	-2,-3	C1	5000	32-34	10	20
2	Linza 1	1610 – sip.	-2	C1	4000	28	10	20
3	Trupi 3	1620 – sip.	I-II	C1	6000	28	10	20
	Shuma				15,000	28-34		

1.4.2 Pasaportat e punimeve te cpim plasjes per frontet e prodhimit, llogaritja e punimeve të shpim plasjes

Parashikimi i puneve të shpim plasjes është bërë duke patur parasysh faktorët e meposhtem:

- Domosdoshmerinë e përdorimit të Lendës Plasese për rrezimin e formacioneve shkëmbore dhe të mineralit të kromit;
- Karakteristikat gjeomekanike të pakove të ndryshme shkëmbore;
- Volumin ditor në m³ masiv;

Pasaporta e shpim plasjes është zbatuar si për avancimin e punimeve kapitale dhe të përgatitjes ashtu edhe për punimet e shfrytëzimit, pra përvoja në këtë drejtim jo vetëm nuk mungon por edhe do të shërbejë për vazhdimësinë e avancimeve dhe shfrytëzimit të mineralit të kromit në vendburimin “Qafë Ujku”.

Si për zbulimin ashtu edhe për nxjerrjen e mineralit përdoret lënda plasëse e kombinuar me cekic hidraulik.

1.4.3 Percaktimi i vendit për depozitimin e sterileve, llogaritja e kapacitetit depozitues

Sterilet e dala nga proceset e hapjes së punimeve minerare do të depozitohen në venddepozitimin e përcaktuar sipas kordinatave në hyrje të galerisë (Shiko figurën Nr.5). Më pas këto sterile do të mund të depozitohen përsëri në shpatet e secilës galeri, atje ku është zhvendosur minerali i kromit.

Keoficiënti i zbulimit për vitin 2023 sipas matjeve faktike e llogaritjeve që u janë bërë rezulton të jetë 7.17 m³ steril/ton mineral.

1.4.3.1 Ngarkimi,tansporti.

Ngarkimi i mineralit në dalje të galerisë do të bëhet me anë të eskavatorit. Transporti do të bëhet me automjetin 20 tonësh që shoqëria e zotëron. Në ringritjen e punimeve dhe hapjen e tyre do të bëhet me krah si ngarkim dhe transporti me vagon të kthyeshëm.

I gjithë minerali shfrytëzuar në objektin “Qafë Ujku”, si ai i përfutur nga punimet sipërfaqësore dhe nëntokësore do të transportohet për në impiantin e pasurimit, një impiant ky i cili do të prodhojë kështu koncentrat kromi me permbajtje 49% Cr₂ O₃, i rikuperuar në masën 66%. Impianti i pasurimit do të ndërtohet në pjesën perëndimore, në fund të zonës minerare.

1.4.3.2 Ajrimi, sigurimi teknik, plani i likujdimit të avarisë.

Ne do të punojmë në nen/toke, dhe në sipërfaqe, meqë do fillojmë një galeri të re nga sipër, dhe me që do punojmë me një plasje në 24 ore, dhe dritë në 70 ml ne do bëjmë ajrimin me ajër të komprimuar 30 minuta kohë, me tutje do të vendosim ventilatore shtues.

Ventilatorët e ajrimit lokal do të jenë të një tipi me ventilatorin stacionar qendror me qëllim që të rritin e të zvogelojnë prodhimtarinë në funksion të këtyre të fundit

1.4.4 Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë

Nga ana kompanisë do të zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë, në punët e shpim-plasjes, ngarkim e transport edhe të gjithë preceseve të tjera të punës në minierë. Frontet do të kontrollohen para fillimit të punës për të evituar rrezikun nga coprat e varura, duke njoftuar drejtuesin teknik kur nga përgjegjësi i frontit mendohet se ka shikallë rrezikshmërie.

Likujdimi i birave të paplasura do të bëhet sipas rregullave që ekzistojnë për këtë qëllim në frontin e punës pas plasjes.

Percaktimi i kapacitetit prodhues

Grafiku i punimeve kryesore te hapjes deri ne arritjen e kapacitetit **4000 ton/vit.**

Prodhimi realizuar nga shfrytezimi i këtij vendburimi në zonën e kërkuar do të ketë si destinacion pasurimin në fabrikë dhe eksportin e koncentratit.

Percaktimi i jetes se minieres

Me sasinë e disponueshme të rezervave prej rreth 4000 ton dhe me shtimin e mundshem të tyre, jeta e minierës paraprakisht mund të shkojë rreth 3-5 vjet.

1.5 Instalimi i impiantit të pasurimit të mineralit të kromit

Impianti i pasurimit te mineralit te kromit eshte pozicnuar ne pjesen perendimore te zones minerare.

Impianti i pasurimit te mineralit te kromit do te jete ne funksion te aktivitetit kryesor sic eshte shfrytezimi i mineralit te kromit ne vendburimin "Qafe Ujku". E gjithë sasia e mineralit te kromit qe do te nxirret nga aktiviteti i shfrytezimit te galerise nentokesore dhe karieres siperfaqesore te zones minerare objekti "Qafe Ujku", do te futet ne procesin e pasurimit duke prodhuar koncentrat kromi me permbajtje 49.00 % Cr₂O₃, i rikuperuar ne masen 66.00 %.

Linja e Pasurimit te Kromit zhvillohet mbi bazen e skemes teknologjike te pasurimit te kromit dhe gjithë industria do te jete kryesisht ne terren te hapur por edhe ne disa objekte te mbuluara teresisht ose pjeserisht.

Impianti i pasurimit te kromit perbehet nga disa reparte, te cilet pershkruhen si me poshte:

- C. Sheshi i depozitimit te kromit
- D. Sheshi i repartit te thyerjes
- E. Reparti i bluarjes dhe klasifikimit
- F. Reparti i pasurimit me separatorete spirale
- G. Reparti i pasurimit me tavolina
- L. Sheshi i cujezimit te sterilite te met
- M. Sheshi i dambes se sterileve te thata
- N. Dy vaskat e cujezimit te koncentratit
- O. Sheshi i depozitimit te koncentratit
- Q. Sheshi i objekteve ndihmese;oficina,magazina,dushe dhe garderobe,menca,zyrat,laboratori dhe fjetorja.

Hyrja ne objekt do te kryhet nga rruga qe mund ta qujame kryesore nga ku behet komunikimi me minieren e cila ndodhet ne kuoten me te larte ne reference me zhvillimin e objektit tone. Ajo devijohet ne krahun e djathte duke zbritur me nje pendece rreth 15% dhe ne pjesen e pare te saj

ne do te hapemi me nje shesh te madh ku do te vendoset edhe Peshorja. Kete e kemi quajtur Sheshi C, tek I cili do te behet depozitimi i lendes se pare si dhe peshimi i automjeteve bosh dhe plot.

Sheshi ka nje rreze te madhe per te lehtesuar rrotullimin e kamioneve. Ngjitur me sheshin e Depozitimit te lendes se pare ne drejtimin verior merr zhvillim gjithë linja e pasurimit. Direkt nen te kemi sheshin D i cili eshte fillimi i vendosjes se bunkerave ne kuoten e sheshit C. Pas tij kalojme ne Sheshin E, Repart ku do te kryhet bluarja dhe klasifikimi. Makinerite do te vendosen ne platforma beton sipas kriterëve te funksionimit te makinerive.

Ne Sheshin F do te kryhet pasurimi dhe do te vendosen disa spirale ne lartesi te madhe. Ne 2m mbi kete repart do te ndërtohet nje kapanon te mbuluar dhe te hapur nga anet e tij. Ne kete kapanon do te vendosim tavolinat e pasurimit te cilat kane nje peshe te madhe dhe kryejne levizje me vibrim dhe do ta quajme reparti G.

Ne te djathte te tij kemi nje vaske cujezimi te koncentratit 21m x 12m dhe do ta quajme N.kjo vaske zhytet ne toke ne piken maksimale te saj rreth 1.5m dhe ne 3 anet e saj ka mure betony ndersa dyshemeja e saj nje beton me pjerresi duke arritur nga kuota e tokes nivelin -1.5 m. Ne te majte te saj kemi nje vaske tjetër cujezimi te sterilit te imet me dimension 30m x 20m e cila thellohet 2m nen nivelin e tokes dhe do ta quajme Sheshi L.

Ajo do te ndërtohet me mure betoni ne 3 anet e saj ndersa ne pjesen lindore dhe ne mesin e saj muret do te krijohen me materialin e thate te saj. Ne pjesen me lindore te sheshit te poshtem ndodhet edhe Sheshi M i cili do te jete edhe damba natyrale e linjes se pasurimit te kromit. Ajo do te jete nje shesh i madh i rrethuar me mure te krijuara nga materiali i tepert ose sterili.

E gjithë Linja e Pasurimit te Kromit pershkohet me rruge te gjere 4m dhe rakordime me rreze 15m per kamionet. Sheshi Q eshte i pari qe ka kontakt me rrugen pasi le Sheshin C.

Sheshi Q do te jete vendndodhja e objekteve ndihmese qe do te jene ne konteniere funksionet e te cilave jane:

- Oficina – 1 kontenier
- Magazine – 2 konteniere
- Laboratori – 1 kontenier
- Zyre – 1 kontenier
- Fjetore – 1 kontenier
- Dushe dhe garderobe – 2 konteniere
- Menca – 1 kontenier

I- Reparti i Thyerjes se Mineralit

Xeherori vjen me makina vetshkarkuese nga miniera, dhe shkarkohet ne sheshin e depozitimit te lendes se pare, ose direkt ne bunkerin e lendes se pare. Nje fadrome mbush bunkerin e lendes se pare me xeherorin e depozituar ne shesh. Meqenese miniera eshte afer impiantit, kapaciteti i sheshit te depozitimit u parashikua me kapacitet 500 ton.

Mbi bunker eshe vendosur nje grille statike me hapsire drite 300mm. Grila siguron qe copat aksidentale me mbi 300 mm te mos kalojne ne linjen e thyerjes. Po keshtu grila eshte mase preventive per te eleminuar aksidentet ne bunker.

Copat me granulometri mbi 300 mm thyhen nga puntoret e thyerjes me vare. Minerali i depozituar ne bunker ka granulometri nen 300mm.

Ne repartin e thyerjes behet thyerja e mineralit nga copat me permasa nen 300 mm, ne copa me permasa nen 20 mm (copat maksimale). Thyerja behet ne dy shkalle ne cikël te hapur me shoshen vibruese. Ne vazhdim jepet pershkrimi i procesit teknologjik te thyerjes se mineralit.

II- Dozimi mineralit

Minerali nga bunkeri i akumulimit dozohet ne procesin e thyerjes me anen nje ushqyesi, dozatori.

Dozatori ka syprine me shina me hapsire drite 75.00mm

Dozatori kryen dy funksione teknologjike:

- Ben sitisjen e mineralit ne dimensionet nen 75 mm.
- Ben dozimin e mineralit ne thyesin me nofulla.

Dozatori ushqen procesin e thyerjes me kapacitet 30 t/h. Gjate punes, minerali nga bunkeri kalon ne dozator. Klasat granulometrike nen 75 mm bien ne nje transportier me shirit gome. Klasat mbi 75 mm dozohen ne thyesin me nofulla 400mmx600 mm, ku behet thyerja e tyre ne copa me granulometri nen 75 mm.

III- Thyerja e mineralit ne thyesin me nofulla (shkalla e pare e thyerjes)

Klasat mbi 75 mm nga dozatori hyjne ne gryken e thyesit me nofulla. Thyesi me nofulla ben thyerjen e mineralit nga copa me granulometri nen 300mm, ne copa me granulometri nen 75 mm. Per thyerje te mineralit nga 300 ne 75 mm thyesi me nofulla ka kapacitet 25.00 t/h, meqenese 5 ton/ore kalon nen grilen statike dhe nuk hyn ne thyesin me nofulla. Shkalla e thyerjes ne kete rast eshte $i=4$, qe eshte e pranueshme per thyerjen me nofulla.

Minerali i thyer nen 75 mm, qe del nga thyesi me nofulla bie ne nje transportierin me shirit. Minerali qe del poshte dozatorit dhe ai i thyer ne thyesin me nofulla (nen 75 mm) bien ne te njejtin transportier me shirit, qe ben transportin e mineralit ne shoshen vibruese.

IV- Sitisja e minerali te thyer

Minerali i thyer nen 75 mm nga transportieri bie ne shoshen vibruese. Shosha ben ndarjen e mineralit ne dy klasa granulometrike. Shosha ka keto parametra:

Shosha ka rrjete celiku me permasa 1200x2400mm. Rrjeta ka hapsire drite 20 mm. Shosha do te vendoset mbi dy thyesat me nofulla te shkalles se dyte te thyerjes. Fraksioni – 20 mm qe del poshte shoshes, bie ne nje transportier me shirit, kurse fraksioni + 20 mm (mbi shosha), bie ne dy thyesat me nofulla 1000mm x 250mm, shkarkimi i dy thyesave me nofulla me granulometri – 20 mm, bie ne te njejtin transportier me shirit, ku bie fraksioni nen site. Ky transportier e con materialin e thyer nen 20 mm ne bunkerin e xeherorit te thyer para mullirit te bluarjes.

Para shoshes vibruese instalohet mbi transportierin me shirit nje elektromanjet, i cili thith copat hekurore te rastit, duke mbrojtur keshtu dy thyesat me nofulla te shkalles se dyte.

Hekurishtet nga elektromanjeti largohen me dore nga puntori repartit te thyerjes. Dy thyesat me nofulla te shkalles se dyte perballojne kapacitetin, qe ka fraksioni mbi shoshe, qe parashikohet te jete me pak se 20 ton ne ore. Keta thyesa realizojne thyerjen e xeherorit nga 75 mm ne 20 mm.

Minerali thyer nen 20 mm dhe fraksioni nensite, - 20 mm, depozitohen ne bunkerin e mineralit te imte, qe ndodhet para mullirit te bluarjes. Nen bunkerin e xeherorit te thyer – 20 mm, eshte

montuar nje dozator elektrovibrus, i cili ben dozimin e mineralit mbi nje transportjer me shirtit. Dozatori do te dozoje 20.00 ton/h, ne perputhje me skemen teknologjike te impiantit. Mbi transportier do te vendoset nje peshore elektronike, qe do te beje peshimin automatik te xeherorit vazhdimisht dhe do ta regjistroje ate.

V- Reparti i bluarjes se mineralit

Ne kete repart behet bluarja e mineralit 100% nen 1.00mm. Bluarja kryhet ne mulli me shufra. Bluarja behet ne te laget ne cikël te mbyllur me shoshen, qe lejon kalimin e grimcave nen 1 mm per ne repartin e pasurimit, kurse grimcat me te medha se 1 mm rikthehen perseri ne mulli, deri sa te arrijne madhesine nen 1 mm dhe keshtu te kalojne nen site dhe me tej ne repartin e pasurimit. Kryhet keshtu cikli i mbyllur i bluarjes. Shkalla e bluarjes se mineralit nen 1 mm diktohet nga perberja mineralogjike e xeherorit. Bluarja behet per te cliruar mineralin e kromitit nga mineralet sterile, qe perbejne xeherorin. Per bluarje te mineralit 100% nen 1.00mm kemi nje shkalle te larte te clirimit te mineralit te dobishem, kromitit dhe te mineraleve sterile.

Kujdes gjate procesit te bluarjes duhet te tregohet, qe bluarja te realizohet 100 % nen 1 mm, duke formuar sasi sa me te vogla te fraksionit nen 0.07 mm, i cili pasurohet me tregues te ulet me menytrat gravimetrike te pasurimit. Per me teper separatorët spirale, qe do te perdoren per pjesen kryesore te pasurimit, nuk i kapin pothuajse fare grimcat e kromit me madhesi nen 0.07 mm. Analiza granulometrike e mineralit te bluar nen 1.00mm tregon se kur rreth me shume se 35 % e mases se mineralit eshte ne klasat nen 0.07 mm, treguesit e pasurimit perkeqesohen. Minerali i bluar me kete perberje granulometrike pasurohet me tregues jo te mire. Kjo sasi e tejbluar e mineralit (shllamet) do te shoqeroje ne te gjitha hallkat e procesit te pasurimit masen e mineralit te bluar mbi 0.07 mm (rerat).

VI- Bluarja e mineralit

Per te kryer bluarjen e mineralit eshte zgjedhur mulli me shufra, se keta mullinj bluajne xeheroret me granulometri uniforme dhe formojne me pak shllame gjate procesit te bluarjes, per shkak te hapesirave, qe krijohen midis shufrave gjate bluarjes, sepse midis tyre ndodhen copat e xeherorit, qe nuk i lejojne shufrat te takohen me njera tjetren. Bluarja e mineralit behet me shufra ne te laget.

Mulliri eshte i veshur me pllaka metalike, sepse keshtu realizon kapacitet me te madh. Permbajtja e te ngurtes ne pulpen brenda mullirit eshte 50% (raporti mineral - uje eshte 1:1). Minerali nga transportjeri, nepermjet nje ulluku dergohet ne ushqyesin e mullirit. Ulluku ka pjerresi 30 grade dhe siguron levizjen e mineralit deri ne gryken e ushqyesit te mullirit. Ne kete ulluk shtohet edhe sasia e ujit per bluarjen e mineralit.

Sasia e ujit eshte 20 m³/ore. Minerali se bashku me ujin nepermjet nje ushqyesi, qe eshte montuar ne hyrje te mullirit hyn ne mulli.

Per shkak te levizjes rrotulluse te mullirit, lind forca centrifugale e cila kerkon t'i shtyje mineralin dhe shufrat drejt periferise se tij. Po keshtu ne mulli vepron edhe forca e gravitetit, qe kerkon t'i zbresi mineralin dhe shufrat poshte. Bashkeveprimi i ketyre dy forcave ben, qe gjithë masa e mineralit dhe shufrave te ngjitet deri afer pikes kritike. Ne piken kritike mjeti blueares (shufrat) dhe minerali shkeputen dhe bien poshte. Gjate renies behet goditja e mineralit nga shufrat. Kjo ben qe minerali te bluhet. Shufrat ne mulli levizin ne forme katarakti dhe me rokullisje. Minerali i bluar leviz drejt grykes se shkarkimit te mullirit. Ne mineralin e bluar, qe del nga mulliri ka ende material me

granulometri mbi 1.00mm. sasia e materialit te pa bluar llogaritet ne rreth 30 % (6.6 t/h) te sasise se mineralit fillestar

VII- Sitisja e mineralit te bluar

Pulpa e mineralizuar, qe del nga mulliri me permbajtje rreth 50 % te ngurte kalon ne siten, qe ben ndarjen granulometrike te materialit te bluar ne dy klasa. Sita ka rrjete me hapsire drite 1.20 mm.

Sita ben ndarjen e mineralit te bluar ne dy klasa granulometrike:

1. Mineral i bluar nen 1.00mm (nen site)
2. Material mbi 1.00mm (mbi site)

Klasat nen site me granulometri nen 1.00 mm kalojne per pasurim gravimetrik.

Klasat mbi site, rikthehen per bluarje ne mulli.

VIII- Pompimi pulpes ne repartin e pasurimit gravimetrik

Pulpa e mineralizuar mbas procesit te bluarjes (nensita) ka permbajtje te te ngurtes rreth 30 %. Pulpa me kete densitet, me vetrrjedhje bie ne koshin e pompes centrifugale. Pulpa pompohet ne repartin e pasurimit gravimetrik, ne nje hidrociklon, ku ndahet fraksioni i imet nen 0.07 mm nga fraksioni -1+0.07 mm, i cili hyn ne pasurim ne separatoret spirale.

IX- Reparti pasurimit gravimetrik

Pasurimi gravimetrik i mineralit te bluar nen 1.00 mm kryhet ne separatore spirale. Pasurimi kryhet ne kater shkalle, ne cikël te mbyllur. Perdoren operacioni baze, operacioni i pastrimit dhe operacionet e kontrollit. Per pasurimin gravimetrik te mineralit (per kapacitet 20.00 ton/ore) do te sherbejne 24 cope separatore spirale. Gjithashtu do te perdoren tavolina koncentrimi per pasurimin e shllameve.

X- Parapregatitja e mineralit per pasurim ne tavolina

Minerali bluar nen 1.00 mm (nensita) ka ne perberjen e tij klasa te ndryshme granulometrike. Keto klasa perbehen nga nje sere mineralesh, qe jane perberes te xeherorit, qe pasurohet. Kemi keshtu nje perzjerje kokrizash me dimensione dhe pesha specifike te ndryshme. Kjo ben qe edhe sjellja e ketyre grimcave gjate procesit te pasurimit te jete shume e pa percaktuar. Per te siguruar nje proces gravimetrik ne parametra optimale dhe te kontrollushem duhet, qe minerali i bluar paraprakisht te deshllamohet nga shllamet (grimcat e bluara nen 0.07mm), process qe kryhet ne hidrociklonin e instaluar siper separatoreve spirale. Fraksioni nen 0.07 mm trajtohet ne tavolinat e koncentrimit qe jane konstruktuar per pasurimin e shllameve.

XI- Deshllamimi i xeherorit te bluar ne hidrociklon

Minerali i bluar (nensita) me vetrrjedhje hyn ne koshin e pompes centrifugale. Pulpa me densitet rreth 30 % te ngurte pompohet me presion rreth 1.5 atm. ne hidrociklon. Ne hidrociklon behet ndarja e mineraleve sipas granulometrise se tyre. Ndarja behet per shkak te konfiguracionit, qe ka hidrocikloni dhe forcave, qe lindin gjate levizjes rrotulluse, qe kryen pulpa ne hidrociklon. Nga bashkeveprimi i forcave centrifugale dhe forces se gravitetit, behet ndarja e pulpes minerale ne dy fraksione granulometrike. Nga ndarja ne hidrociklon perftohen dy produkte:

1. Nenderdhja e hidrociklonit (rerat)
2. Mbiderdhja e hidrociklonit (shllamet)

Keto dy produkte kane perberje granulometrike te ndryshme dhe do te pasurohen ne linja te vecanta.

XII- Pasurimi ne separatore spirale

Xeherori i bluar dhe i deshllamuar futet ne separatoret spirale te operacionit baze, ku ndahet ne tre produkte, parakonzentrat, gjysem produkte dhe sterile. Parakonzentrat dhe gjysem produktet bashkohen dhe dergohen me pompe ne separatoret spirale te operacionit te pastrimit, ku ndahet ne tre produkte, koncentrat perfundimtar, gjysem produkt dhe sterile. Gjysem produkti bashkohet me sterilet dhe futet ne pompen e pare, duke shkuar keshtu perseri ne operacionin baze. Sterilet e operacionit baze futen ne pompen e trete, e cila i dergon me presion ne nje hidrociklon te instaluar mbi separatoret spirale te operacionit te kontrollit te pare, ku ndahen shllamet nga produkti ranor, si edhe behet cujezimi i produktit. Pas deshllamimit sterilet e operacionit baze futen ne separatoret spirale te operacionit te kontrollit te pare, ku ndahen ne tre produkte, parakonzentrat, gjysem produkte dhe sterile.

Parakonzentrat se bashku me gjysem produktin bien ne pompen e pare, e cila i con perseri ne operacionin baze, kurse sterilet bien ne pompen e katert, e cila i con me presion ne nje hidrociklon, ku behet deshllamimi dhe cujezimi dhe pastaj futen ne separatoret spirale te operacionit te kontrollit te dyte, ku ndahen perseri ne tre produkte parakonzentrat, gjysem produkte dhe sterile perfundimtare, nga te cilet parakonzentrat bie ne pompen e trete dhe dergohet ne operacionin e pare te kontrollit, gjysem produkti futet ne mullirin e dyte te ribluarjes dhe pas ribluarjes futet ne pompen e trete dhe dergohet ne kontrollin e pare te spiraleve, kurse sterilet perfundimtare dergohen ne procesin e cujezimit.

Sterilet perfundimtare te separatoreve spirale futen ne nje klasifikator spiral, ku behet deshllamimi dhe cujezimi i tyre. Rerat e klasifikatorit jane sterilet ranore me permbajtje te lageshtise nen 15 % H₂O dhe keto jane te transportueshme dhe parashikohet, qe te perdoren per mbushjen dhe shtrimin e rugeve dhe shesheve. Kurse kaperderdhja e klasifikatorit spiral bashkohet me kaperderdhjet e hidrociklonave dhe futen ne nje site statike, ku pastrohesh nga mbeturina ose ashkla qe kane hyre aksidentalisht ne pulpe. Nen sita bie ne nje pompe pulpe centrifugale qe i dergon ne nje bateri hidrociklonash me diameter 75 mm, ku behet largimi i shllameve nen 10 mikron, te cilat nuk mund te pasurohen, gjithashtu behet edhe cujezimi i pulpes. Shllamet nen 10 mikron me nje sasi te konsiderueshme uji dergohen ne cujezimin e sterileve te imta.

Kurse fraksioni -70 mikron + 20 mikron futet ne tavolinat e pasurimit te shllameve, te cilat rikuperojne grimcat e imta, qe se separatoret spirale nuk munden t'i rikuperonin, ne perputhje me karakteristikat pasuruese te tyre. Koncentrat perfundimtar cujezohet ne procesin e cujezimit, ne vaska dekantimi dhe pas kesaj, koncentrat evadohet per shitje. Kurse sterilet ndahen vecan ne sterile ranore, qe evadohen per t'u perdorur ne shtrimin e rugeve dhe shesheve, ose per mbushjen e hapësirave te shfrytezimit te karrieres; dhe sterile te imta, te cilat cujezohen ne nje dambe provizore me permasa 30m x 20m dhe cdo dy jave cvendosen ne damben e sterileve, ku cdo tre muaj perseri transportohen per mbudhjen e hapësirave te shfrytezimit ne karriere. Uji, qe del nga procesi i cujezimit riqarkullohet per t'u riperdorur perseri ne impiant.

XIII- Pasurimi ne tavolinat e koncentrimin

Pasurimi ne tavolina kryhet ne rrymen e pjerret te ujit, qe rrjedh mbi siperfaqen e tavolines. Tavolina ne baze te konstruksionit te saj dhe levizjeve eksentrike ben, qe grimcat me pesha specifike te ndryshme te marin drejtim te ndryshem te levizjes se tyre mbi tavoline. Nga bashkveprimi i te gjitha forcave qe veprojne mbi grimcat e ngurta behet e mundur qe grimcat e mineralit te kromit te levizin ne drejtim diagonal me aksin e tavolines. Grimcat me te lehta te sterilite levizin ne drejtim perpendikular me aksin e tavolines. Keto grimca rrembehen me lehte nga rryma e ujit. Grimcat me te rrenda te kromit levizin pergjate kanaleve te tavolines dhe rrembehen me me veshtiresi nga rryma e ujit. Gjate punes ne tavoline krijohen zona ku grimcat levizin ne vartesi te peshes specifike dhe dimensionit te tyre. Keto zona shkarkohen ne ulluqet perkatese. Ne rastin tone ne tavolinat e koncentrimin do te pasurohen grimcat me te imta 75 mikron deri ne 10 mikron, prandaj mer rendesi te vecante rregullimi i hapit dhe frekuences se tavolinave ne perputhje me madhesine e grimcave, qe trajtohen ne to. Ne kemi zgjedhur ndarjen e produkteve ne tavolina ne dy produkte. Nga pasurimi ne tavolinat e shllameve do te perftohen dy produkte qe jane:

Koncentrat kromi perfundimtar, qe shkon ne procesin e cujezimit te koncentratit.

Sterile te imta perfundimtare, qe shkojne ne procesin e cujezimit te sterileve te imta.

Sasia e pergjithshme e shllameve perben rreth 35-40 % te lendes se pare. Trajtimi dhe pasurimi tyre do te kryhet ne linjen e shllameve. Shllamet jane pulpa me densitet 7-9% te ngurte. Nga analiza granulometrike e shllameve rezulton se ato kane perberje komplekse, qe nuk favorizon pasurimin direkt te tyre ne tavolinat e koncentrimin. Shllamet kane ne perberjen e tyre rreth 10-12 % klasa granulometrike mbi 0.10mm. Keto klasa jane shume te varfra, ato permbajne 2-3% Cr2O3. Keto klasa ulin permbajtjen e kromit ne shllame. Po keshtu shllamet kane ne perberjen e tyre edhe rreth 10 % klasa granulometrike nen 0.01mm. Klasat nen 0.01mm (nen 10 mikron) pengojne dukshem pasurimin e shllameve. Grimcat nen 0.01mm nuk i nenshtrohen forcave qe veprojne gjate pasurimit ne tavolinat e koncentrimin. Ato risin viskozitetin e pulpes ne tavolina dhe pengojne edhe pasurimin e grimcave te tjera. Keto shllame te tejbluara ngjiten ne siperfaqen e tavolinave dhe mbushin kanalet e tyre duke prishur konfiguracionin e siperfaqes se tavolines.

Kjo ben qe tavolina, ne fare pak kohe te kthehet ne nje plan te thjeshte ne te cilin nuk mund te kete proces

pasurimi. Vecimi i shllameve te tejbluara (shllameve nen 0.01mm) eshte nje process i domosdoshem. Ndarija e ketyre shllameve, sic e treguam edhe me siper, kryhet ne hidrociklone me diameter 75mm. Shllamet paraprakisht sitisen ne siten statike. Kjo behet, qe nga shllamet te largohen ashkelat e drurit dhe mbeturinat e tjera, qe shoqerojne shllamet. Largimi ketyre mbetjeve siguron nje pune normale ne baterin e hidrocikloneve. Theksojme se grykat e shkarkimit te rerave te hidrocikloneve 75mm jane shume te vogla. Ato kane diameter 8mm dhe bllokohen lehtesisht nga keto mbeturina.

Shllamet qe perftohen ne nensiten statike me vetrrjedhje hyjne ne koshin e pompes centrifugale te shllameve. Pompa e dergon pulpen e shllameve me presion rreth 1.5 atm ne baterin e hidrocikloneve 75 mm.

Ne hyrje te hidrocikloneve pulpa ka densitet rreth 7-9% te ngurte

Nga trajtimi shllameve ne baterine e hidrocikloneve perftohen dy produkte qe jane:

Mbiderdhja e hidrocikloneve (shllamet ultrafine). Nenderdhja e hidrocikloneve (rerat) Mbiderdhjet e hidrocikloneve 75mm jane sterile perfundimtare. Ato nuk mund te trajtohen me tej per pasurimin gravimetrik te tyre (jane material pothuajse argjilor).

XIV- Pasurimi nenderdhjeve te hidrocikloneve 75 ne tavolina lekundese

Nenderdhjet e hidrocikloneve jane pulpa me densitet rreth 25 % te ngurte. Ato tani jane pastruar nga shllamet ``argjilore`` dhe mund te trajtohen per pasurim ne tavolinat e koncentrimit. Nenderdhjet e hidrocikloneve permbajne rreth 1.5 % Cr2O3 mbi ate te shllameve te pergjithsheme.

Syprinat e tavolinave te shllameve kane konfiguracion qe favorizon pasurimin e grimcave kaq te imta. Pasurimi kryhet ne cikel te hapur. Tavolinat ndajne vetem dy produkte

1. Koncentrat kromi i imet perfundimtar.
2. Sterile te imta perfundimtare.

Nga pasurimi shllameve perftohet koncentrat kromi me rreth 45 %Cr2O3 dhe rikuperim rreth 8 % te kromit te pergjithshem. Koncentrati i kromit, qe perftohet ne linjen e shllameve me vetrjedhje kalon ne sistemin e ulluqeve te koncentratit dhe bashkohet me koncentratet e tjera ne vasken e dekantimit te koncentratit.

Ne fund, nga gjithë procesi teknologjik i pasurimit perftohen dy produkte perfundimtare qe jane:

1. Koncentrat kromi
2. Sterile

Koncentrati i kromit depozitohet me dekantim ne vaskat e koncentratit. Sterilet shkojne per t'u depozituar ne vasken natyrale te cujezimit te sterileve te imta, qe do te ndertoht ne afersi te impiantit. Gjate depozitimit te sterileve ne vasken natyrale, qe formohet me vete sterilin e dekantuar, behet ndarja e ujit nga materiali i ngurte. Uji i pastruar kaperderdh vasken natyrale dhe me veterjedhje derdhet ne xumfin e pompes se ujit, ku futet edhe uji i fresket edhe uji qe vjen nga cujezimi i koncentratit te kromit dhe me pompe dergohet per perdorim ne process, duke bere keshtu riqarkullimin e 90 % te sasise se ujit te perdorur. Uji nepermjet pompes centrifugale (pompes se ujit) dergohet ne cisternat e ujit. Cisternat e ujit kryejne dy funksione:


1. Furrnizojne me uje rrjetin e tubacionev te impiantit.
2. Mbajne kostant persionin e ujit ne rrjet. Kjo sigurohet nepermjet nje tubi shkarkimi te vendosur ne pjesen e siperme te depozites. Ky tubi shkarkimi ben qe kollona hidrostatike e uji ne rrjetin e impiantit te mbetet i pa ndryshuar gjate gjithë kohes.

Ndersa sterili ranor ndahet me klasifikator spiral dhe eshte i cujezuar, mund te depozitohet dhe te transportohet me lehtesi per rregullimin e rrugeve dhe shesheve, sterili i imet ka me shume veshtiresi ne cujezimin dhe depozitimin e tij.

Sipas projektit sterili i imet do te hyje ne vasken natyrale (ose damba provizore) te cujezimit, qe eshte nje siperfaqe me dimensione 20m x 30m, e rrethuar me mure rreth 2 m te larta te formuara me vete sterilin e imet. Ketu sterili i imet do te ece duke dekantuar, deri sa ne fund te nje rruge prej 100 m te jete ndare uji i paster nga materiali i ngurte, i cili dekanton brenda vaskes natyrale.

Kapaciteti i vaskes natyrale eshte rreth 4000 ton, qe prodhohen pasi impianti te kete punuar per dy-tre jave me kapacitet te plote 20 t/ore me 24 ore ne dite. Parashikohet, qe damba provizore te pastrohet me fadrome, duke larguar sterilin e depozituar ne te cdo dy ose tre jave, ditet e shtuna dhe te djela. Sterili i hequr nga damba provizore me fadrome do te depozitohet ne damben e sterileve te thata me dimensione 30m x 20m. Kjo ka kapacitet 20000 ton, qe eshte baraz me nje kohe te punes se impiantit prej 3 muajsh. Gjate kesaj kohe mendohet, qe sterili i imet dhe i thate te transportohet e te depozitohet ne hapesirat e shfrytezuara te karrieres, me qellim edhe te kryerjes se procesit te rehabilitimit te pasojave te shfrytezimit te karrieres.

Tabela. Treguesit teknologjike te pasurimit



1.5.1 Perdorimi i ujit ne proces

Ne procesin e impiantit te pasurimit te kromit nuk perdoren fare reagent kimike. Procesi i pasurimit gravitativ dhe te gjitha proceset e tjera, si bluarja, kifikimi, dekantimi perdorin vetem ujin klas dhe nuk perdorin asnje reagent kimik.

Sasia e ujit te perdorur ne proces ne te gjithe impiantin eshte:

39.8 l/sek ose 143.28 m³/ore ose 3438 m³/24 ore.

Nga kjo sasi uji 90 % e tij do te riqarkulloje vazhdimisht, kurse 10 % e sasise se ujit mbetet ne produktet koncentrat dhe sterile, te cilet permbajne rreth 6-8 % H₂O dhe pjesa tjetere humbet nga avullimi ne atmosphere. Dmth: 35.82 l/sek, ose 128.95 m³/ore, ose 3094.85 m³/24 ore do te riqarkullojne. 3.98 l/sek, ose 14.33 m³/ore ose 343.87 m³/24 ore do te kompesohen me uje te fresket, qe do te meret nga burimet ujore me lejen perkatese te perdorimit te ujit. Konsumi i ujit teknologjik te riqarkulluar, qe perdoret ne proces do te jete 7.16 m³/ton lende te pare ose 44.36 m³/ton koncentrat te prodhuar.

Nga keto:

Konsumi i ujit teknologjik te riqarkulluar, qe perdoret ne proces do te jete 6.45 m³/ton lende te pare ose 39.92 m³/ton koncentrat te prodhuar.

Konsumi i ujit te fresket, qe kompenson humbjet e ujit do te jete 0.72 m³/ton lende te pare ose 4.44 m³/ton koncentrat te prodhuar.

Pas procesit te pasurimit prodhohen vetem dy produkte perfundimtare;

1. Koncentrat kromi, ne sasi 3.23 ton/ore, i konvertuar ne te thate, ne forme pulpe me permbajtje te ngurtës rreth 10 %, ku sasia e ujit, qe e shoqeron eshte rreth 29 m³/ore. Kjo pulpe futet ne nje

vaske betoni dekantimi, ku koncentratit i kromit bie poshte dhe dekantoni shpejt per shkak te densitetit te larte qe ka, kurse uji qe kapërderdh vasken, riqarkullon ne procesin e pasurimit, duke shkuar ne pompen, qe rikthen ujin e riqarkulluar.

Pasi mbushet vaska, hiqet porta e saj e levizeshme dhe lihet koncentratit te drenazhoje, dhe pastaj pas drenazhimit, koncentratit meret me fadrome dhe përgohet ne sheshin e koncentratit. Paralel me kete vaske eshte edhe nje vaske tjeter betoni per cujezimin e koncentratit, e njejte, qe sherben per te funksionuar gjate kohes, qe vaska e pare eshte ne procesin e drenazhimit dhe heqjes se koncentratit me fadrome. Dhe keshtu alternohet puna pa nderprerje me funksionimin e dy vaskave.

2. Sterili i separatoreve spirale, ne forme pulpe, ndahet ne nje klasifikator spiral ne steril perfundimtar ranor me granulometri $-1\text{mm}+0.07\text{mm}$, i cili eshte ne sasi rreth 9.22 ton/ore, me lageshti 12 % H₂O dhe nuk permban substanca te demshme apo te rrezikshme; ky product eshte i transportueshem dhe mund te perdoret per shtrimin e rrugeve, apo te shesheve, ose mund te perdoret per rehabilitimin e efekteve te shfrytezimit te karrieres, qe menaxhon investitori. dhe ne kapërderdhjen e klasifikatorit spiral, e cila vazhdon t'i neneshtrohet procesit te pasurimit te metejshem ne tavolinat e koncentrimin, nga ku prodhohet sterili i imet, ne forme pulpe, me permbajtje te te ngurtes rreth 5 %, me granulometri -0.1 mm , i cili eshte ne sasi rreth 7.55 ton/ore te ngurte (konvertuar ne te thate), edhe ky nuk permban substance te demshme apo te rrezikshme. Kete sasi sterili e shoqeron nje sasi uji prej 143.45 m³/ore. Sterili i imet ne forme pulpe futet ne nje vaske me permasa 30m x 20m, te krijuar me mure rrethuese 2 m te larta, me vete sterilin e imet. Sterili i imet dekantoni gjate levizjes se tij ne kete vaske, keshtu ne fund te vaskes del uje i paster, per riciklim, i cili bie ne pompen e ujit te ricikluar, ku hyn edhe uji, qe del nga cujezimi I koncentratit edhe uji I fresket, qe meret nga burimet ujore. Pompa e riciklon ujin ne depozitat e ujit te impiantit, prej nga uji teknologjik perdoret ne impiant.

Vaska natyrale, ose damba e perkoheshme, ne perpthje me kapacitetin orar te sterileve, mbushet per nje periudhe disa mujore ne varesi te funksionimit. Pasi ajo mbushet, dhe impianti nuk punon ajo hiqet me fadrome sterili i imet i dekantuar, duke e cvendosur ne damben e sterileve te thata, qe do te jete shume pak larg dambes provizore.

Ne impiantin e pasurimit te kromit nuk do kete fare shkarkime ne process, sepse i gjithe uji i perdorur do te riciklohet. Uji qe do te futet ne process, do te meret nga burimet ujore, ne sasine prej 4 l/sek.

Impianti i pasurimit nuk do te kete fare shkarkime, sepse i gjithe uji teknologjik, pasi te pastrohet, do te riciklohet, duke u perdorur perseri ne proces. Sasia e ujit te ricikluar eshte sa 90 % (35.82 l/sek) e ujit, qe do te perdoret, vetem 10 % e sasise se ujit do te sigurohet nga burimet ujore, si uje i fresket, qe do te kompesoje humbjet.

1.6 Infrastruktura ndihmëse e nevojshme (rruge aksesit, furnizim me ujë, energji, infrastruktura për mbetjet – si do të menaxhohen mbetjet e shpimit)

Energjia elektrike do të sigurohet nga linja ekzistuese për të cilën shoqëria disponon kontratë me operatorin e shpërndarjes.

Kurse përsa i përketë sigurimit të ujit, uji i cili do të futet në proces do të meret nëpërmjet burimeve ujore, ku për sigurimin e ujit shoqëria disponon leje përdorimi. Nga sasia totale e ujit që do të përdoret në proces 90 % e tij do të riqarkullojë vazhdimisht, kurse 10 % e sasisë së ujit mbetet në produktet koncentrat dhe sterile, të cilat përmbajnë rreth 6-8 % H₂O dhe pjesa tjetër humbet nga avullimi në atmosferë. Çka do të thotë se në proces një sasi shumë e vogël uji do të kompensohet me ujë të freskët që do të merret nga burimet ujore me lejen përkatëse të përdorimit të ujit.

Lidhja telefonike do të bëhet me telefona mobile.

Kurse përsa i përketë infrastrukturës rrugore, ajo është ekzistuese pasi shoqëria siç edhe e kemi cituar operon prej vitesh në zonë. Ajo në mënyrë të vazhdueshme kujdeset për mirëmbajtjen e rrugëve të aksesit, përveç rrugëve ekzistuese mund të lindë nevoja për hapje dhe ndërtim rrugësh të reja aksesit. Këto rrugë do të konsiderohen si të brendshme dhe do të bëjnë të mundur lidhjen e zonave të shfrytëzimit me impiantin e pasurimit.

Kurse përsa i përketë infrastrukturës rrugore për aksesimin e zonës minerare, zona përshkohet nga rruga automobilistike Klos- Qafe Burreli, e cila është një rrugë me taban, por që mirëmbahet në mënyrë të vazhdueshme nga kompanitë që operojnë në zonë, përseri kërkon përmirësime nga ana e pushtetit vendor.




Figure 1: Zona e zhvillimit të projektit në lidhje me infrastrukturën rrugore

1.7 Programi per ndertimin, kohezgjatjen e ndertimit

Punimet ndërtimore/përgatitore për të dy komponentët e projektit mund të zgjasin për një periudhë 6 mujore. Kjo është koha normale që duhet për të përfunduar ndërtimin e impiantit të pasurimit dhe përshtatjen/hapjen e galerisë nëntokësore të kromit për shfrytëzim.

Fillimisht puna do të fillojë me ngritjen e kantjerit për hapjen punimeve të minierës, dhe do të vazhdojë me nxjerrjen e mineralit të kromit, sipas programit të hartuar nga administrata drejtuese e objektit.

Pas hapjes së punimeve kryesore të minierës në zonën e parashikuar, do të fillojë riparimi dhe/ose ndërtimi i galerive gjatë shtrirjes së trupave minerale. Në këtë fazë do të fillojë puna për përgatitjen e hyrjes së brendshme për të bërë lidhjen e niveleve të shfrytëzimit të trupave minerare, duke bërë të mundur futjen në nëntokë të minatorëve dhe pajisjeve të shfrytëzimit e ajrimit së bashku me ato të ngarkimit të mineralit të sterileve.

Hapja e punimeve kryesore kapitale të minierës do të fillojnë menjëherë pas pajisjes me miratim dhe ndyshimin e lejes mjedisore dhe do të përfundojnë, kur fillon përgatitja e shfrytëzimit të nënkateve. Shfrytëzimi i nënkateve do të vazhdojë derisa shoqëria të shfrytëzojë të gjitha rezervat e përcaktuara. Leja minerare Nr. 1185/1 ka një vlefshmëri maksimalisht deri në 25 (njetzet e pese) vjet me mundësi të zgjatjes vetëm një herë të afatit për 10 (dhjete) vjet.

1.8 Lendet e para që do të përdoren për ndërtimin dhe menyrën e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);

Lëndët e para që do të përdoren për ndërtim përgjatë punimeve nëntokësore, janë: materialet elektrike, lende djegëse dhe vajra lubrifikant, uji, beton si dhe pajisje si transformator, aparatat e ajrimit, lendet plasese (dinamit, kapsolla), shtylla miniere, shtanga, rrjete teli, torket, koka pobiediti, shtylla druri etj. Materialet elektrike do të shërbejnë për riparimin e linjes elektrike si dhe për instalimet elektrike në të gjitha ambientet e shërbimit edhe në brendësi të minierës.

Karburanti dhe vajrat do të shërbejnë për automjetet e transportit si dhe për eskavatorët. Betoni do të përdoret për betonimin e kanaleve të ujrave të drenazhimit, armatim në brendësi të minierës si edhe për ndërtime të tjera që mund të lindin nevojë. Shtylla miniere, shtanga, rrjete teli, torket, koka pobiediti, shtylla druri do të përdoren për armatimin e minierës.

Të gjitha lëndët e para do të sigurohen nga subjekte private të licencuara për tregtimin e tyre.

Uji do të përdoret për shpim dhe me pas do të lihet të denkantojë në brendësi të minierës dhe të depertojë në shtresat e nëntokës në gjendje të lire. Sasia e ujit që do të përdoret do të sigurohet nga ujrat nëntokësore që do të grumbullohen në brendësi të galerisë. Furnizimi me energji elektrike do të bëhet nepermjet linjes elektrike që shoqëria "Vani company" sh.p.k disponon.

Gjithashtu përveçse punimeve nëntokësore shoqëria ka planifikuar të instalojë edhe linjën e pasurimit të mineralit të kromit. Minerali i shfrytëzuar nga aktiviteti sipërfaqësor dhe nëntokësor do të transportohet në brendësi të zonës minerare ku do të instalojë impianti për t'u nenshtruar procesit të

pasurimit duke prodhuar keshtu koncentrat kromi me permbajtje 49% Cr₂O₃, i rikuperuar ne masen 66%.

Përgjatë fazës përgatitore, ndërtimore për instalimin e impiantit të pasurimit do të lindë nevoja për përdorim të lëndëve të para, të cilat do të konsistojnë si: materiale elektrike, materiale hidraulike, ujë, kapriata metalike, stuktura të ndryshme hekuri, beton, zhavor, panele sandëich, kontenierë të cilët do të shërbejnë si ambiente mbështetëse si zyra etj. Përsa i përketë energjisë elektrike ajo do të sigurohet nëpërmjet linjës ekzistuese, pasi sic edhe e kemi cituar zona minerare ka qen një zone ekzistuese e shfrytëzuar me parë, gjithashtu shoqëria “Vani Company” Sh.p.k është është një kompani me eksperiencë shumëvjeçare në fushën e shfrytëzimit dhe pasurimit të kromit në vendin tonë. Kurse përsa i përketë sigurimit të ujit, shoqëria është pajisur me Leje për Përdorim Burimi Ujorë Nëntokësor me qëllim përdorimi uji në fabrikën e pasurimit të kromit. Sasia e ujit e cila do të përdoret përgjatë proceseve të pasurimit, deri në 90 % e tij do te riqarkulloje vazhdimisht, kurse 10 % e sasise se ujit mbetet ne produktet koncentrat dhe sterile. Cka do të thotë se në procesin e pasurimit uji është me cikël të mbyllur. (Bashkangjitur në Shtojcën Nr.4 do të gjeni lejen e përdorimit të burimit ujore).

Ne kete proces nuk do të kemi përdorim te reagenteve kimike cka do te sjellë qe sterilet nuk kane permbajtje te substancave kimike por vete përbërjen minerale por ne kete rast ne sasi te reduktur te mineralit te kromit.


1.9 Informacion per lidhjet e mundshme te projektit me projekte te tjera ekzistuese perreth/prane zones se projektit;

Aktualishtë shoqëria “Vani Company” Sh.p.k është në kushtet e shfrytëzimit sipërfaqësor të objektit minerar “Qafë Ujku”, zona minerare Nr. 1185/1, ku për zhvillimin e këtij aktiviteti ajo është pajisur me Leje Mjedisore të tipit B me PN-2101-05-2024.

Shfrytëzimi i vendburimit me galeri nëntokësore eshte trajtuar si një sektor i rëndësishëm me qëllim administrimin sa më mirë të rezervave të kromit të cilat përbejnë në fakt edhe pasurinë më të rëndësishme të këtij sektori.

Shfrytëzimi i rezervave të mineralit të kromit nëpërmjet punimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore do të përmbushë kështu nevojën për sigurimin e lëndës së parë të mineralit të kromit. Më pas i gjithë minerali i përfutur në vendburimin “Qafe Ujku”, do ti nënshtrohet procesit të pasurimit duke prodhuar keshtu koncentrat kromi me permbajtje 49% Cr₂O₃, i rikuperuar ne masen 66%.

Pranë zonës minerare Nr. 1185/1, objekti “Qafë-Ujku” ndodhen disa aktivitete ekzistuese të cilat operojnë në shfrytëzimin e mineralit të kromit. Ku disa prej tyre janë: shoqëria “Gerad Krom” Sh.p.k, shoqëria “MINERZA-22” Sh.p.k, shoqëria “BESJANA” Sh.p.k, shoqëria “Ceruja” Sh.p.k etj.



Zona minerare objekti "Qafë Ujku", në lidhje me zonat e tjera minerare në afërsi

Sic mund të shikohet edhe ne ortofoton e mësipërme, zona kryesohet nga vendburimet e mineralit të kromit, e cila përbën edhe sektorin më të rëndësishëm ekonomik në zonë.

Sic e kemi cituar edhe më sipër Objekti "Qafë Ujku", Shfrytëzim Mineral Kromi" është një zonë minerare ekzistuese, e shpallur si e tillë që në vitin 2012, shoqëria do të vazhdoj ta shfrytëzoj kete zonë minerare me qëllim nxjerrjen e rezervave të mineralit të kromit.

Aktualishë në sipërfaqen e zonës minerare/karrierës jane të vendosura edhe aktivitetet ndihmëse, plotesuese te shfrytëzimit te mineralit si:

- Siperfaqe per magazinim minerali, sterili.
- Ambientet ndihmese (zyra, magazina etj)

1.10 Informacion per alternativat e marra ne konsiderate

Sic e kemi permendur edhe me larte, vendburimi është një vendburim ekzistues. Ku puna për hapjen dhe shfrytëzimin e minieres ka filluar shume vite me pare.

Shoqëria "VANI COMPANY" Sh.p.k, disponon një leje minerare ekzistues të miratuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës në vitin 2012 për një periudhë vlefshmërie maksimalisht deri në 25 (njetzet e pese) vjet me mundesi të zgjatjes vetem një herë të afatit për 10 (dhjete) vjet.

Kjo vendodhje është përcaktuar si e vetmja alternative si pasojë e burimit të mineralit të kërkuar.

Konform kushteve dhe afateve te kesaj kontrate Alternativa midis Alternatives Zero dhe Alternatives me Projekt , Qeveria shqiptare ka zgjedhur alternativën me projekt, ku ka ftuar kompanite private dhe jo vetem te konkurojne me alternativën me projekt teknik me eficient per kete veper.

Sa i takon projektit te fituar ne kete leje minerare , subjekti fitues ne kete rast ka paraqitur një projekt eficient per perdorimin dhe shfrytëzimin e zonës minerare, për këtë ajo është shpallur fituese.

Gjithashtu shoqëria përgjatë periudhave është pajisur me disa miratime, të cilat janë në ndihmë të aktivitetit, si leje për përdorim uji me qëllimin përdorimin e ujit në fabrikën e pasurimit të kromit. Të dyja zhvillimet e propozuara si shfrytëzimi i rezervave nëntokësore nëpërmjet riaktivizimit të galerisë nëntokësore, apo instalimin e impiantit të pasurimit, do të konsiderohen nga ana e shoqërisë si investime parësore dhe mjeftë të rëndësishme të cilat lidhen ngushtësisht me njëra-tjetrën dhe ndihmojnë në menyrë të drejtpërdrejtë shoqërinë, duke përmbushur kështu pikë së pari nevojat për sigurimin e lëndës së parë të mineralit të kromit dhe pasurimin e saj duke prodhuar kështu koncentrat kromi me përmbajtje 49% Cr₂O₃, i rikuperuar në masën 66%.

1.11 Te dhena për përdorimin e lendeve të para gjatë funksionimit

Nisur nga fakti që ky aktivitet është aktivitet shfrytëzimi i burimeve natyrore, nuk përdoren lende të para por sigurohen lende të para të cilat janë minerali i kromit.

Lëndet e para ndihmëse që do të përdoren gjatë kohës së funksionimit të impiantit të pasurimit janë: Energjia elektrike dhe uji. Energjia elektrike do të sigurohet nga linja ekzistuese për të cilën shoqëria disponon kontratë me operatorin e shpërndarjes. Kurse përsa i përketë sigurimit të ujit, uji i cili do të futet në proces do të merret nëpërmjet burimeve ujore, ku për sigurimin e ujit shoqëria disponon leje përdorimi.

1.12 Aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit

Duke qenë se aktiviteti është ekzistues prej vitesh, shoqëria “Vani Company” Sh.p.k ka përshtatur dhe ndërtuar cdo infrastrukturë të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit. Gjatë kësaj periudhe ajo ka siguruar ambientet e administratës, ka instaluar në vend disa kontenierë të cmontueshëm për të ardhur në ndihmë punonjësve.

Mirëpo gjatë projektimit dhe ndërtimit të impiantit të pasurimit, shoqëria ka riorganizuar ambientet ndihmëse/mbështetëse të aktivitetit. Shoqëria ka projektuar të ndërtojë ambientet ndihmëse si: Magazina, Oficina, Gushe dhe Garderobë, Menca, Zyrat, Laborator dhe Fjetore.

1.13 Kopje të lejeve, autorimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar,

Shoqëria “Vani Company” Sh.p.k aktualisht disponon:

1. Leje Minerare Shfrytëzimi Nr. 1185/1 për shfrytëzimin e mineralit të kromit, Objekti “Qafe Ujku”.
2. Leje Mjedisore të Tipit B;
3. Leje Përdorimi uji;
4. Kontrata për furnizimin me energji elektrike;

Shoqeria pas pajisjes me vendim per projektin e propozuar do ti nenshtrohet procedures per ndryshim te kushteve te lejes mjedisore.

1.14 Identifikimi dhe masat zbutese

Faza përgatitore (Hapja e galerise ekzistuese nëntokësore dhe ndërtimi i impiantit të pasurimit)			
Nr.	Receptori Mjedisor	Ndikimi	Ndikimi i mundshëm
1	Cilësia e ajrit	Gjenerim pluhuri për shkak të operacioneve të punimeve përgatitore për minieren nëntokësore dhe instalimin e impiantit të pasurimit, si dhe të gjithë infrastrukturën ndihmëse.	Ndikim i ulët në cilësinë e ajrit, vetëm brenda zonës së impiantit, ndikim i përkohshëm.
2	Zhurmë	<p>Zhurmë e gjeneruar nga operacionet e punës për shfrytëzimin e mineralit të kromit në galerinë nëntokësore, makineritë e përdorura dhe lëvizja e tyre për transportin e lëndës së parë në impiantit të pasurimit.</p> <p>Zhurmë e gjeneruar nga operacionet e shpërthimit me lëndë plasëse.</p> <p>Emetimet e zhurmës gjatë fazës së ndërtimit të impiantit të pasurimit.</p>	<p>Ndotje akustike. Zona minerare objekti "Qafë Ujku", ndodhet larg qendrave të banuara, kështu që rritja e nivelit të zhurmave nuk do të krijojë probleme për qendrat e banuara dhe banorët, probleme krijohen vetëm për faunën në sipërfaqen e objektit, kryesisht gjatë procesit të levizjes së automjeteve, përshtatjes së sipërfaqes për impiantit dhe procesit të plasjeve në objektin nëntokësore.</p> <p>Bazuar edhe në referencat ndërkombëtare, zhurmat teknologjike nga mjetet e rënda që përdoren për operacione ndërtimore e japin efektin e tyre akumulativ deri në një rreze prej 150-200 m, në varësi edhe të konfiguracionit natyror të terrenit, i cili shërben si barrierë natyrale etj.</p> <p>Gjenerimi i zhurmave të ardhura nga proceset e shpërthimit, nuk do të kenë një frekuencë të shpeshtë. Ky ndikim nuk do të jetë i ndjeshëm jashtë zonës minerare. Ndikim i përkohshëm.</p> <p>Zona minerare ndodhet në një distancë të konsiderueshme nga objektet e banimit apo qendrat e</p>

			banuara.
3	Cilësia e ujërave	Ndotje e ujrave sipërfaqësor/nentokesore.	<p>Gjate fazes përgatitore të galerisë uji i përdorur për shpim si dhe ujerat nentokesore do të lihen të dekantohen në brendësi të minierës dhe më pas të depertojnë në gjendje të lirë në shtresat e nentokes.</p> <p>Thëksojmë se ujerat nentokesor që do të përdoren për shpim kanë të njëjten përmbajtje të mineraleve me galerinë pasi rrjedhin në brendësi të galerive dhe nuk konsiderohen si ndotës të shtresave të nentokes.</p> <p>Ndikim i përkohshëm, kontrollohet dhe shmangët me masat e duhura të menaxhimit.</p>
4	Përdorimi i tokës/Peisazhi	Ndryshimi i peisazhit të zonës.	<p>Aktualishtë projekti i propozuar do të konsistojë në shfrytëzimin e vendburimit nëpërmjet riaktivizimit të galerisë nëntokësore. Për këtë arsye ky ndikim nuk do të quhet si i tillë.</p> <p>I vetmi ndikim në peisazh përgjatë kësaj faze do të lidhet me vendëpozitim të sterileve dhe përshtatjen e sipërfaqes për ndërtimin e impiantit të pasurimit. Gjithësesi duke vlerësuar zonën e studimit ky ndikim do të konsiderohet i papërfillshëm, pasi zona minerare ndodhet në një distancë të konsiderueshme nga receptori njërrëzor. Në afërsi të zonës minerare objekti “Qafë Ujku”, gjenden vetëm disa zona të tjera minerare.</p>
5	Toka	Rrjedhje aksidentale të karburanteve dhe lubrifikantëve të tjerë.	Të gjitha proceset përgatitore, ndërtimore përgjatë projektit të propozuar do të shtrihen brenda sipërfaqes së lejes minerare nr.

			<p>1185/1.</p> <p>Të vetmet ndikime të mundshme përgjatë kësaj faze do të lidhen me:</p> <p>Ndikime në gjeologji dhe tokë përfshirë pastrimin e mbulesës së bimësisë, heqjen e shtresës së sipërme të dheut, punime të ndryshme gjatë fazës së gërmimit për përshtatjen e gjithë infrastrukturës së nevojshme për ndërtimin e impiantit të pasurimit.</p> <p>Në mënyrë tipike, procesi i gërmimit dhe heqja e shtresës së sipërme të tokës dhe bimësisë mund të rezultojë në ndryshime të regjimit të kullimit dhe rrjedhjes sipërfaqësore në terren, veçanërisht gjatë sezonit të lagësht. Për këtë arsye përgjatë sipërfaqeve ndërtimore (impiantit të pasurimit dhe venddepozitimit të sterileve), duhen të ndërtohen kanalet e drenazhimit dhe orientimit të ujrave. Pasi këto ndryshime të mundshme do të mund të ndikojnë në ritjen e erozionit sipërfaqësor brenda zonës minerare.</p> <p>Sasia e mbetjeve të dheut/inerteve të gjeneruara përgjatë fazës ndërtimore të impiantit në pjesën më të madhe të tyre do të riperdoren përgjatë fazës sistemuese/rehabilituese. Pjesa e mbetur e konsideruar si tepric do të depozitohet në venddepozitimin e përcaktuar në lejen mjedisore atë të sterileve të gjeneruara nga karriera sipërfaqësore.</p> <p>Kompania do të zbatonte të gjitha rregullat e sigurimit teknik për të shmangur ndikimin nga rrjedhja aksidentale e lubrifikanteve</p>
6	Flora & Fauna	Shqetësim dhe largim i mundshëm i llojeve të faunës si rezultat i	Si në fazën përgatitore por edhe gjatë fazës së funksionimit të

		shfrytezimit te zones minerare.	<p>aktivitetit, flora e zones nuk do te ndikohet nga aktiviteti i shoqerise "Vani Company" Sh.p.k, kjo per dy arsye:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kemi te bejme me shfrytezimin e nje miniere nentokesore. 2. Aktualisht shoqëria ushtron aktivitetin e nxjerrjes së mineralit të kromit nëpërmjet punimeve siperfaqësore. <p>Persa i perket faunes do te kemi shqetesim te saj nga zhurmat e gjeneruara nga mjetet e punes, mjetet e transportit, lëndët plasëse. Por përsëri ky ndimin nuk do të konsiderohet si i tillë, pasi shoqëria aktualisht ushtron aktivitetin e tij në kushte dhe normal pune, e gjithë zona në afëris është një zonë industriale minerale, ku të vetmet zhvillime janë ato të shfrytëzimit të mineralit të kromit.</p>
7	Mjedisi socio ekonomik	Mundësi të mira punësimi.	<p>Ndikimi në aspektet sociale dhe ekonomike të zonës është mjaft pozitiv, pasi shoqëria do të risë ndjeshëm numrin e punëtorëve duke ndikuar kështu në rritjen e mundësive për punësim të komunitetit lokal. Duhet theksuar se sektori minerare eshte nje nga sektoret me te rendesishem ne zone. Fuqia punetore do te sigurohet nga banoret e zonave perreth, kjo do te rrise te ardhurat e tyre. Rritje e te ardhurave ne buxhetin e shtetit nepermjet sistemit te taksave.</p>
8	Menaxhimi mbetjeve urbane	Ndikimi ne mjedisin e zones	<p>Mbetjet qe do te gjenerohen gjate procesit te pershtatjes/hapjes se galerise vleresohet te jene mbetje urbane si kartona, qese dhe ambalazhe te lendes se pare. Ato do te mblidhen ne fund te dites se punes dhe do te cohen ne vendet e percaktuara nga Pushteti Vendor.</p>